



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 9 shkurt 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Ndryshimin e Datës së Konferencës së Tretë për Ecurinë e Çështjes

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE¹, në bazë të nenit 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

1. Më 3 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi të mbante një konferencë për ecurinë e çështjes ("konferenca e tretë për ecurinë e çështjes") në prani të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe ekipeve të Mbrojtjes, të enjten, më 11 shkurt 2021, në orën 11:00 ("Urdhri").²

2. Për arsye organizative dhe pasi ka marrë parasysh disponueshmërinë e palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ta ndryshojë datën e konferencës së tretë për ecurinë e çështjes për të **martën, 16 shkurt 2021, në orën 11:00**.

3. Gjatës seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve informacion të përditësuar, nëse ka, për pikat e përcaktuara në Urdhër.³ Gjykatësi vëren se ZPS-ja⁴ dhe Zyra Administrative⁵ kanë dorëzuar parashtrimet e tyre në lidhje me këto pika brenda afatit të përcaktuar në Urdhër.⁶ Afati i ekipeve të Mbrojtjes për dorëzimin, në qoftë se dëshirojnë, të parashtrimeve me shkrim në lidhje me cilëndo nga këto pika dhe/ose pika të tjera, mbetet dita e mërkurë, 10 shkurt 2021, në orën 12:00.⁷

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00185, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe Dorëzimin e Parashtrimeve*, 3 shkurt 2021, publik.

³ Urdhri, para. 15-16.

⁴ KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Tretë mbi Ecurinë e Çështjes*, 8 shkurt 2021, publike.

⁵ KSC-BC-2020-06, Administratorja, *Parashtrime të Administratores në lidhje me Përkthimet*, 8 shkurt 2021, publike.

⁶ Urdhri, para. 17, 19(b), (d).

⁷ Urdhri, para. 17, 19(c).

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 9 shkurt 2021
Në Hagë, Holandë.